



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**NR. 4 REGJ. THEM.**

**NR. 4 VENDIMI**

**DATË 29.03.2021 REGJ.**

**DATË 31.03.2021 VENDIMI**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i përbërë nga :

**KRYESUESE : Edlira PETRI**

**ANËTAR : Gentjan MEDJA**

**ANËTARE : Alma KOLGJOKA**

**ANËTARE : Esmeralda ÇEKA (XHILI)**

**ANËTARE : Emona MUÇI**

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, në datë 31.03.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen zgjedhore nr. 4 regjistri themeltar, datë 29.03.2021 që i përket:

**PADITËS :** Subjekti Zgjedhor, Koalicioni “ALEANCA” (AL), përfaqësuar në gjykim nga Z. Eduart Abazi, kryetar i partisë Aleanca Demokratike Shqiptare, udhëheqëse e koalicionit, si dhe Av. Erjon Syziu anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë me nr. 4685 license.

**I PADITUR :** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga Z. Olsi Peto.

**OBJEKTI :** - Ndryshimin e Vendimit Administrativ nr. 165, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për “Refuzimin e Listave shumëmemërore të koalicionit Aleanca (AL) për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021; - Ndryshimin e Vendimit Administrativ nr. 11, datë 24.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për “Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 06, dt.

20.03.2021 të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca (AL)”; - Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të regjistrojë Listën Shumëemërore të kandidatëve për deputet në Parlamentin e Shqipërisë në zgjedhjet Parlamentare të datës 25 Prill 2021, sipas Listave të propozuara nga Koalicioni “Aleanca” (AL) për kandidatët e propozuar nga Koalicioni Aleanca me përbërje dy Parti Politike (Partinë Aleanca Demokratike Shqiptare dhe Partinë e Reformave Demokratike të Shqipërisë).

**BAZA LIGJORE :** Ligji 10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i përditësuar; Udhëzimi nr. 1, datë 23 Dhjetor 2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

### **KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**

pasi dëgjoji përfaqësuesit e palës paditëse, që kërkuan pranimin e padisë; përfaqësuesin e palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë; administroi aktet e paraqitura; si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi

### **VËREN:**

#### **FAKTET E ÇËSHTJES:**

Me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, Presidenti i Republikës ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Në kuadër të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (në vijim referuar edhe si KSHZ) janë regjistruar si të tilla edhe : 1. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare (vendimi nr. 30, datë 05.02.2021 i KSHZ); 2. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet (vendimi nr. 50, datë 11.02.2021 i KSHZ); 3. Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë (vendimi nr. 36, datë 05.02.2021 i KSHZ); 4. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (vendimi nr. 65, datë 15.02.2021 i KSHZ); 5. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare (vendimi nr. 67, datë 15.02.2021 i KSHZ); 6. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve (vendimi nr. 90, datë 22.02.2021 i KSHZ); 7. Partia Qytetare Shqiptare (vendimi nr. 87, datë 22.02.2021 i KSHZ)<sup>1</sup>. Në vijim, pas përfundimit të regjistrimit të partive politike, u realizua regjistrimi i koalicioneve zgjedhore dhe me vendimin nr. 108, datë

<sup>1</sup>Shih <http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/03/Regjistri-parti-koalicione-2021.pdf>

02.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u regjistrua si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, koalicioni zgjedhor “Aleanca” (AL). Koalicioni zgjedhor rezultoi të përbëhet nga shtatë partitë politike të sipërcituara dhe mbi bazën e marrëveshjes së tyre, partia udhëheqëse e tij është Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, me kryetar Z. Eduart Abazi.

Në datë 08.03.2021, koalicioni Aleanca (AL) paraqiti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listat shumëmemërore të kandidatëve për deputetë, si dhe dokumentet e kandidimit. Pas verifikimit të listave të paraqitura dhe dokumentacionit të kandidimit, me vendimin nr. 138, datë 11.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi : *“1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Koalicionit “Aleanca”, (AL) për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. 2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021. ...”*

Me këtë vendim KSHZ konstatoi mangësi në dokumentacionin e kandidimit. Para së gjithash evidentohet se : *“1. Koalicioni “Aleanca” nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetimin për zotërimin e 2 (dy) mandateve në Kuvend. Partitë pjesëtare të koalicionit “Aleanca” nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkërisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. Gjithashtu nuk janë paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare.”* Në vijim, janë renditur edhe një sërë mangësish të tjera, që lidheshin me mos respektimin e kërkesave të Kodit Zgjedhor për ndalimin e kandidimit të të njëjtit kandidat në më shumë se një zonë zgjedhore (me përjashtim të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit); mungesën e kartës së identitetit të kandidatit; parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit; mungesë të gjeneraliteteve të kandidatit; parregullsi e listës së kandidatëve sipas nenit 67.4 të Kodit Zgjedhor (mungesë e kandidatit nr. 1 të një liste, numër më i vogël kandidatësh se sa ai i përcaktuar në Kodin Zgjedhor); mos respektim i gjinisë së nën përfaqësuar (një në çdo tre emra të listës); plotësim i gabuar i deklaratës së kandidatit modeli 05 për të gjitha zonat zgjedhore.

Në datë 18.03.2021 u zhvillua seanca dëgjimore për marrjen e vendimit përfundimtar mbi depozitimin e listave shumëmemërore të koalicionit Aleanca (AL). Objekt shqyrtimi ishin listat e kandidatëve të depozituara pas kthimit për korrigjim.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 165, datë 18.03.2021 vendosi :** *“Refuzimin e listave shumëmemërore të koalicionit Aleanca (AL) për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25*

*Prill 2021. ...*”. Vendimi i KSHZ-së u bazua mbi të njëjtin argument, lidhur me mos plotësimin e kushtit për zotërimin e shtatë mandateve të koalicionit, sikurse në evidentimin edhe të disa mangësive të tjera në dokumentacionin e kandidimit (ndalimi i kandidimit të të njëjtit kandidat në më shumë se një zonë zgjedhore, plotësimi i gabuar i deklaratës Model-05, etj).

Në datë 20.03.2021, koalicioni Aleanca (AL), depozitoi pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim referuar edhe si KAS), ankimin ndaj vendimit nr. 165, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ankuesi, në mënyrë të përmbledhur, ngriti këto pretendime :

- Për sa i përket nenit 68, pika 3 të Kodit Zgjedhor, meqenëse pesë subjekte pjesë e këtij koalicioni, nuk paraqitën kandidatët e tyre në listat e depozituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kjo nënkupton se këto parti u tërhoqën nga gara dhe mbetën vetëm dy subjekte, me dy mandate mbështetëse: 1. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare (AD) 2. Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë (PRDSH). Në mbështetje të këtij argumenti, pala ankuese paraqiti në datën 23.03.2021 Deklaratën e datës 12.03.2021 e cila pasqyron faktin se: Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve dhe Partia Qytetare Shqiptare janë tërhequr nga koalicioni Aleanca (AL), si edhe një deklaratë tjetër e po të njëjtës datë me ane të së cilës, dy partitë e tjera shfaqin vullnetin të vijnë garë në koalicion. Në këto kushte, listat shumëmemërore me kandidatë për deputetë, dorëzuar pranë KQZ-së, kanë shprehur qartë respektimin e detyrimit ligjor, ku secili subjekt garues në koalicion duhet të mbështetet nga një mandat.
- Duke ballafaquar vërejtjet për korrigjim sipas vendimit nr. 138, datë 11.03.2021, me vërejtjet e paraqitura në vendimin nr. 165, datë 18.03.2021, me ndonjë përjashtim nuk rezultojnë të qenësishme sepse : 1. Në vendimin objekt ankimi janë konstatuar mangësi në dokumentet e kandidatëve pjesë e listës së parë, për të cilat nuk ka patur vërejtje sipas vendimit nr. 138, datë 11.03.2021 të Komisionerit; 2. Nga Komisioneri janë konstatuar me mangësi në dokumentacion disa kandidatë, të cilët janë zhvendosur në lista nga qarku në qark, edhe pse dokumentet e këtyre kandidatëve kanë qenë të depozituara dhe të vlerësuara si të rregullta në qarqet ku ishin propozuar në listat e dorëzuara në datën 08.03.2021.
- Në lidhje me plotësimin gabim të formularit Model-05, ai dukshëm dallon që është një gabim shtypi.

**Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 11, datë 24.03.2021, vendosi :** “1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.06, datë 20.03.2021 të subjektit zgjedhor koalicioni Aleanca (AL). 2. Lënien në fuqi të vendimit nr.165. datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca (AL), për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021...””.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve arsyetoi se :

1.Në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor “Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.”. Pikërisht në ushtrim të kësaj të drejte koalicioni ALEANCA, i përbërë nga 7 parti politike ka paraqitur kërkesën për t’u regjistruar në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Në zbatim të urdhërimeve të nenit 65 të Kodit Zgjedhor që parashikon se “Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”, koalicioni në fjalë ka depozituar gjithashtu në KQZ marrëveshjen përkatëse.

Sikurse është pranuar edhe nga përfaqësuesi i subjekti ankimues në ankimin e tij por edhe në deklaratimet në seancë, në momentin e paraqitjes në KQZ të kërkesës për regjistrimin e listave të kandidatëve për Kuvendin (në datën 08.3.2021), Koalicioni Aleanca (AL) nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht koalicioni ka paraqitur vërtetimin për zotërimin e vetëm 2 (dy) mandateve në Kuvend, ndërkohë që sipas dispozitës përkatëse, që koalicioni të regjistrohej si i tillë duhet të zotëronte të paktën 7 (shtatë) mandate. Në alternativë, koalicioni duhej të kishte paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7000 (shtatë mijë) zgjedhës në shkallë kombëtare. Ky rregull i materializuar në pikën 1 të nenit 68 është një kusht thelbësor i detyrueshëm për t’u respektuar nga koalicioni dhe mosrespektimi i tij passjell refuzimin e regjistrimit të listave shumemërore.

2. Me ridorëzimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë, pas kthimit për plotësim nga Komisioneri, duke qenë se sipas formimit të koalicionit me 7 parti politike, asnjë nga këto kushte të kërkuara nga ligji (7 mandate deputetësh apo listë mbështetëse me 7000 zgjedhës) nuk mund të plotësohej, 5 nga 7 partitë politike përbërëse të koalicionit ALEANCA kanë deklaruar me deklaratën e datës 12.3.2021 tërheqjen e tyre nga koalicioni Aleanca (AL) duke mbetur në koalicion tashmë vetëm 2

parti politike të cilat po sipas Deklaratës, shfaqin vullnetin të vijojnë garën, dhe konkretisht: - Partia Aleanca Demokratike Shqipëtare (AD), - Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë (PRDSH) Duhet evidentuar fakti se Deklarata e mësipërme nuk është paraqitur si provë gjatë seancës “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore...” të mbajtur nga Komisioneri në datën 18.3.2021. Madje në referim të procesverbalit të kësaj seance, i cili u administrua si provë nga KAS, nuk rezulton që përfaqësuesi i koalicionit ALEANCA të ketë ngritur pretendimin e ekzistencës së kësaj Deklarate edhe pse ajo mban datë 12.3.2021, pra përpara zhvillimit të kësaj seance publike. Madje referuar përsëri procesverbalit të seancës “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore...”, rezulton se përfaqësuesi i koalicionit z. D. Mullahaj, ka paraqitur argumente kontradiktore përpara Komisionerit, herë duke pretenduar se partitë politike që nuk kishin mbështetje në numër mandatesh në Kuvend janë tërhequr nga listat, herë duke pretenduar se partitë nuk janë tërhequr nga koalicioni, por se koalicioni tashmë përfaqësohet vetëm nga dy sigla partish politike. Ndryshe nga sa u deklarua në seancë, në asnjë moment, përfaqësuesi i koalicionit në KQZ nuk ka kërkuar të administrohet Deklarata e datës 12.03.2021 ku pasqyrohet fakti se 5 parti përbërëse të koalicionit janë tërhequr duke mos qenë më pjesë e tij.

3. KAS vlerëson se pretendimi i parashtruar në seancë se 5 nga 7 partitë politike përbërëse të koalicionit ALEANCA janë tërhequr nga koalicioni, dhe se tashmë koalicioni ALEANCA përbëhet vetëm nga dy parti politike të cilat duhet të vijojnë regjistrimin e listave shumemërore të kandidatëve, është një argument juridik i cili nuk gjen mbështetje në Kodin Zgjedhor. Tërheqja nga koalicioni i shumicës së partive pjesëmarrëse në të, pasi ky koalicion është regjistruar si i tillë në KQZ, në vetvete, është një veprim i cili pamundëson vijim e mëtejshëm të garës në formë koalicioni të partive të mbetura. Në këtë rast, de facto jemi para formimit të një koalicioni të ri zgjedhor, i cili nuk është i regjistruar në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor (madje e ka objektivisht të pamundur të regjistrohet për shkak të kalimit të afateve ligjore) dhe si i tillë nuk mund të paraqesë për regjistrim as lista shumemërore të kandidatëve për zgjedhjet e Kuvendit. Refuzimi i listës nga ana e Komisionerit, është pasojë direkte e mangësive të vetë subjektit zgjedhor.

4. Koalicioni konsiderohet i regjistruar në zbatim të nenit 65 të K.Zgjedhor dhe nga ai moment fiton personalitetin juridik si subjekt zgjedhor në formën e koalicionit. Pika 1 e këtij neni parashikon se “Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve”. Për këtë arsye, është e pamundur që në tejkalim të këtij afati të fitojë personalitet një

koalicion tjetër, qoftë ky dhe me uljen e numrit të partive politike në një koalicion të regjistruar. Duke qenë se Partia Aleanca Demokratike Shqiptare (AD) dhe Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë (PRDSH) janë regjistruar si parti politike në përputhje me nenin 64 të K.Zgjedhor, pas tërheqjes nga koalicioni të pesë partive të tjera politike, ato mund të kandidonin vetëm si parti politike në zgjedhjet e 25 prillit 2021 e për rrjedhojë, në zbatim të nenit 67 të K.Zgjedhor, duhet të depozitonin listat e kandidatëve si parti politike në vete dhe jo si koalicion.

5. KAS vlerëson gjithashtu se në referim të Kodit Zgjedhor ekzistonte mundësia që dy partitë politike të mbetura nga koalicioni ALEANCA, duke qenë se janë parti që plotësojnë kushtin e zotërimit të një mandati në Kuvend, të ushtronin të drejtën e tyre për të marrë pjesë në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 duke konkurruar në zgjedhje si parti politike të veçanta, dhe për rrjedhojë duke paraqitur secila në vete listën shumemërore të tyre me kandidatë për zgjedhjet e Kuvendit. Kjo mundësi nuk është shfrytëzuar.

6. KAS vlerëson se Ankuesi nuk arriti të jepte një argumente bindëse në pretendimin e tij se listat shumemërore të kandidatëve për deputetë u ridepozituan në KQZ duke ballafaquar vërejtjet për korrigjim sipas vendimit nr. 138, datë 18.03.2021 dhe se të gjithë kandidatët e koalicionit tashmë kanë dalë nga dy partitë politike, duke u përshtatur kështu formalisht me formën e re të koalicionit, tashmë i përbërë nga vetëm me dy parti. Nga këqyrja dhe vlerësimi në seancë, rezultoi se në listën shumemërore të kandidatëve për deputetë të qarkut Vlorë, e ridepozituar në KQZ pas korrigjimeve të pretenduara nga aukuesi, kandidatët me numër rendor 5, 11 dhe 12 i përkasin përkatësisht partive politike ABDE dhe PQSH, parti të cilat sipas vetë pretendimeve të ankuesit nuk ishin më pjesë në koalicionin Aleanca dhe si të tilla nuk duhet të kishin kandidatë në listat shumemërore të rikorrigjuara. KAS nuk konsideron si argument të mjaftueshëm për t'u marrë në konsideratë pretendimin e palës ankimuese se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një gabim material në hartimin e listave.

7. KAS vlerëson se ankimuesi nuk arriti të provojë se ka plotësuar saktë dokumentacionin e kandidimit të kandidatëve për deputetë në qarqet: Tiranë – kandidati nr. 07; Durrës – kandidati nr. 01 dhe nr. 15; Elbasan – kandidati nr. 13, nr. 14 dhe nr. 15; Shkodër – kandidati nr. 9 dhe nr. 11; Fier – kandidati nr. 01, nr. 06 dhe nr. 16; Kukës – kandidati nr. 02; Vlorë – kandidati nr. 01; Gjirokastër kandidati nr. 02, nr. 04 dhe nr. 06; Lezhë – kandidati nr. 01. Më konkretisht, rezultoi se Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidatë të listës shumemërore të koalicionit Aleanca (AL), Model – 05, rezultojnë të plotësuara në mënyrë jo të saktë për të gjitha zonat zgjedhore edhe pas kthimit për plotësim të listave me vendimin nr. 138, datë

11.3.2021 dhe ridepozitimit së tyre në KQZ. Konkretisht janë konstatuar raste kur ankuesi nuk ka pasqyruar dhe reflektuar në deklaratat shoqëruese të listave të kandidatëve ndryshimet e bëra në listat shumëmemërore të kandidatëve sipas qarqeve; janë konstatuar raste të mungesave të deklaratave të kandidatëve Model 05; janë konstatuar raste kur nuk është plotësuar qarku në të cilin do të kandidojë kandidati si dhe raste kur kandidatët nuk kanë përzgjedhur me (x) përgjigjen për të deklaruar se në cilin qark pranojnë të kandidojnë, në listat shumëmemërore të Partisë/Koalicionit apo si kandidat i mbështetur nga zgjedhësit. Pas rikonfigurimit të listës shumëmemërore të kandidatëve, këto ndryshime duhet të ishin pasqyruar edhe në dokumentacionin e kandidimit të secilit kandidat duke e përshtatur këtë dokumentacion me rikonfigurimin e listës.

8. Nuk qëndron gjithashtu pretendimi i ngritur nga ankuesi në seancë se ishte detyrë e administratës së KQZ që të orientonte saktë përfaqësuesit e Koalicionit për mënyrën e plotësimit të listave shumëmemërore apo të dokumenteve shoqëruese të kandidimit. KAS konsideron se në mbështetje të parimit të prezumimit të njohjes së ligjit, është detyrim primar i subjektit zgjedhor plotësimi paraprakisht i të gjitha kërkesave të neneve 67, 68 dhe 72 të Kodit Zgjedhor në funksion të paraqitjes për regjistrim të listave shumëmemërore të kandidatëve, ashtu sikundër Komisioneri në referim të nenit 73, ka tagrin e verifikimit, kthimit për korrigjim dhe miratimit apo refuzimit të tyre.

## **PROCEDURA GJYQËSORE**

Në datë 29.03.2021 Koalicioni “Aleanca” (AL) depozitoi (nëpërmjet shërbimit postar) pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor (në vijim referuar edhe si Kolegji) ankimin ndaj vendimit të KAS, duke pretenduar se si vendimi i tij, ashtu edhe ai i KSHZ për refuzimin e listave shumëmemërore, ishin të pabazuar në ligj dhe si të tillë duheshin shfuqizuar. Evidentohet se, po në datë 29.03.2021, koalicioni “Aleanca” (AL), depozitoi pranë Kolegjit kërkesëpadinë e tij, të ngritur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me objekt kundërshtimin e vendimeve të KSHZ dhe KAS, sikurse tregohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ridepozitimi konsiston vetëm në rregullimin formal të mjetit procedural, me të cilin mosmarrëveshja zgjedhore u referua në Kolegji, ndërsa nuk ndryshon nga pikëpamja thelbësore e pretendimeve të ngritura në të dy aktet.

Kolegji vlerëson paraprakisht se pala paditëse legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi në cilësinë e subjektit zgjedhor i njihet e drejta të ankohet ndaj vendimeve të KQZ-së, që cenojnë interesat e tij të ligjshme (shih nenin 145 të Kodit Zgjedhor). Paraqitja e listave të kandidatëve për zgjedhjet e Kuvendit është e drejta, që materializon angazhimin e një subjekti zgjedhor në zgjedhjet për të cilat ai është



regjistruar si i tillë. Regjistrimi si subjekt zgjedhor dhe pamundësimi për paraqitjen e listave ndërhyjnë në vetë të drejtën e partisë politike/koalicionit për tu zgjedhur, ndaj interesi i ligjshëm për ngritjen e padisë është ekzistent.

Kolegji konstaton se kërkesëpadia është paraqitur brenda afatit ligjor pesë ditor të parashikuar nga neni 145, në lidhje me nenin 152.2 të Kodit Zgjedhor.

Veç sa më sipër, lidhur me shkaqet për të cilat pala paditëse i kundërshtoi vendimet e KSHZ dhe KAS, Kolegji evidenton se në momentin e depozitimit të kërkesëpadiës, KAS ende nuk kishte kryer komunikimin e vendimit të tij të arsyetuar, ndaj pretendimet e ngritura në këtë moment ishin të njëjta me ato të ankimit administrativ të paraqitur pranë tij. Gjithsesi, pala paditëse kompletoi pretendimet e saj në seancën gjyqësore të zhvilluar nga Kolegji, pasi tashmë ishte njohur edhe me argumentet e KAS, mbi të cilat ishte refuzuar ankimi i saj.

### ***Pretendimet e palës paditëse koalicioni “Aleanca” (AL)***

Sikurse u parashtrua më sipër, pala paditëse rezulton të jetë njohur më vendimin e arsyetuar të KAS, pas depozitimit të kërkesëpadiës, ndaj pretendimet që referojnë në argumentet konkrete të vendimit të kundërshtuar u parashtruan në seancë gjyqësore. Arsyet, për të cilat pala paditëse ankimoi vendimmarrjen e KQZ-së për refuzimin e listave të kandidatëve, janë si vijon :

Së pari : Vlerësimi i KAS apo KSHZ, sipas të cilit koalicioni zgjedhor nuk mund të vijojë nga dy parti politike, nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor. Nuk ka një ndalim, me të cilin të përcaktohet se pas tërheqjes së një apo më shumë partive nga koalicioni, partitë e tjera përbërëse të tij nuk mund të vijojnë rrugëtimin e tyre në zgjedhje si koalicion. Sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor “*Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, mund të regjistrohen në KQZ, si koalicion zgjedhor në shkallë vendi...*”. Pyetja, nëse i plotëson koalicioni “Aleanca” kriteret e koalicionit dy partiak, merr përgjigje nga dispozita e sipërcituar, si dhe nga neni 2 i Udhëzimit nr. 1, datë 23/12/2020, që përcaktojnë kërkesat për ekzistencën dhe kriteret për formimin e koalicionit. Sipas këtyre dispozitave parashikohet se koalicioni përban: a) Shprehjen e vullnetit; b) Emrin e koalicionit; c) Shkronjat nistore; d) Emrin mbiemrin e personit të autorizuar nga partitë pjesëmarrëse i cili cakton vëzhgues; e) Emrin mbiemrin e personit që përfaqëson koalicionin në short; f) Emrin mbiemrin e personit që paraqet kërkesën për regjistrin në KQZ; g) Nr. e kandidatëve të propozuar nga secila parti politike e koalicionit. Përbushja e këtyre kërkesave mund të përbëjë de facto dhe de jure një koalicion

zgjedhor dhe të gjitha këto kërkesa të parashikuara në udhëzim janë plotësisht të përmbushura nga Koalicioni Aleanca (AL).

Subjektet e tërhequr nga Koalicioni Aleanca (AL), kanë përpiluar aktin juridik të tërheqjes nga koalicioni, kurse partitë e mbetura kanë shprehur vullnetin e vijimit të bashkëpunimit me të njëjtat kushtet në koalicion. Administrata e KQZ, pas njohjes me listën e kandidatëve të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca (AL), sipas pikës 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor mund të konstatonte se përbri kandidatit është shënuar edhe partia përkatëse, ku rezulton se të gjithë kandidatët e koalicionit kanë dalë nga dy parti politike. Për sa kohë në ato lista gjenden vetëm emrat e kandidatëve nga dy subjekte politike administrata e KQZ mund të kërkonte shpjegime apo të orientonte subjektin zgjedhor të bënte korrigjimet e duhura në formë shkresore që mund të ligjëronte vijimin e konkurrimit si koalicion me dy subjekte, pa u përballur me penalitete që mund t'i pamundësojnë pjesëmarrjen në zgjedhje.

Pas plotësimit të dokumentacionit ka rezultuar se në garë brenda koalicionit janë përfshirë vetëm dy parti politike të mbështetur nga dy mandate deputetësh konkretisht deputetët Krenar Rryci dhe Majlinda Halilaj. Në këto kushte është e qartë se koalicioni ka vijuar garën me përbërje të dy partive politike dhe se në Kuvendin e Shqipërisë koalicioni përfaqësohet nga dy deputetë. Për sa më sipër, ligjërisht rezulton e plotësuar mangësia e konstatuar në vendimin nr. 165, datë 18.03.2021 të KSHZ dhe për rrjedhojë kjo rrethanë nuk mund të pengojë pjesëmarrjen në zgjedhje të Koalicionit Aleanca (AL) dhe kandidatëve të propozuar prej saj.

Së dyti: është konstatuar se kandidati Klajdi Bufi nuk plotëson kriterin për të marrë pjesë si kandidat në Qarkun e Korçës në listë me nr. rendor 3 dhe në Qarkun Tiranë me nr. rendor 31. Ky konstatim është i vërtetë dhe i atribuohet një gabimi njerëzor, në qarkun e Tiranës kandidati Klajdi Bufi do të zëvendësohet nga koalicioni me një kandidat tjetër, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Së treti : KSHZ, ka vlerësuar se kandidati i propozuar nga Koalicioni në Qarkun Vlorë, Z. Genci SulceSakaj, është subjekt i cili ka pengesë ligjore për të kandiduar sipas parashikimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Shkaku i këtij vlerësimi lidhet me faktin se ky subjekt ka vetë deklaruar një dënim të datës 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me 3 vite burgim dhe gjobë në masën 1 000.000 lekë e konvertuar në dy vjet kohë prove. Ky dënim është amnistuar në datë 24.12.2012. Në lidhje me këtë çështje është kërkuar nga KAS, të rivlerësojë edhe një herë aplikimin e nenit 4 pika 3 të ligjit 138/2015 për kandidatin Genci SulceSakaj, pasi nga dokumentacioni provues, që i është vënë në dispozicion KQZ-

së rezulton se kandidati Sakaj e ka plotësuar afatin e ndalimit të kandidimit prej 10 vitesh. Neni 4, pika 3 e ligjit 138 /2015 ka parashikuar se afati i ndalimit do të llogaritet nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim, sipas vendimit të formës së prerë. Ndërkohë që sipas këtij kuptimi që i jepet në ligj, duhet që sanksioni penal ndaj veprës të jetë zbatuar, pikërisht si një dënim me burgim dhe subjekti ta ketë vuajtur dënimin me burgim. Z. Sakaj i është konvertuar ky dënim në shërbim prove, ai nuk ka vuajtur dënim me burgim, por vetëm i është nënshtruar masave shtrënguese që lidhen me dënimin alternativ, atë të paraqitjes në shërbimin e provës dhe jo dënimin me burgim. Për këtë arsye për këtë subjekt afati i ndalimit të kandidimit duhet të llogaritet nga data e marrjes formë të prerë të vendimit dhe jo nga përfundimi i afatit të provës.

Së katërti: KSHZ ka vlerësuar se janë vërejtur parregullsi në dorëzimin e formularit të vetë deklaramit të disa kandidatëve për deputetë në qarqet Tiranë (kandidati me nr. rendor 07); Durrës (kandidati me nr. rendor 1 dhe 15); Elbasan (kandidati me nr. rendor 13, 14, 15); Shkodër (kandidati 5, 8, 9 dhe 11); Fier (kandidati 1, 4, 6, 13, 16); Kukës (kandidati 2); Vlorë (kandidati 1, 8); Gjirokastrë (kandidati 2, 3, 4, 6); Lezhë (kandidati 1). Për kandidatët e tjerë KSHZ shprehet se ka kërkuar informacion nga institucionet e treta, por se nuk kish marrë ende përgjigje. Në lidhje me këto konstatime, në kërkesën ankimore është sqaruar se në vendimin nr. 165, datë 18.03.2021, KSHZ ka ngritur apo ka konstatuar mangësi, të cilat nuk ishin konstatuar më parë me vendimin nr. 138, datë 11.03.2021, duke u bërë me dije me rastin e kthimit për korrigjim.

Mund të vërtetohet lehtësisht se kandidati me nr. 1 në qarqet Tiranë, Vlorë, Berat Fier është Z. Eduart Abazi i cili sipas vendimit figuron me probleme sa i përket dorëzimit të formularit të vetë deklaramit në qarqet Fier, Vlorë, por nuk figuron me probleme në qarkun Tiranë dhe Berat. Z. Krenar Rryci kandidat me nr. 1 në Durrës sipas vendimit nr. 138, datë 11.03.2021 nuk ka pasur asnjë mangësi apo problem tjetër në dokumentacion etj. Vlerësohet kjo mangësi e pretenduar tek kandidatët, përse i përket plotësimit të gabimeve apo të metave në formularin e vetë deklaramit të një mangësie të një shkalle që nuk duhet të penalizojë të gjithë koalicionin për të përmbushur të drejtën e vetë kushtetuese për garuar në zgjedhje.

Në lidhje me konstatimet e tjera mbi papajtueshmërinë apo problematikën e hasura në kandidatët të veçantë, thuajse për të gjithë kandidatët e propozuar nga Koalicioni ALEANCA, janë konstatuar si mangësi, të dhënat në formularin e vetë deklaramit. Në lidhje me këtë konstatim, KSHZ mund të dispononte me vendim sipas parashikimit të nenit 8, të Udhëzimit nr. 1, datë 23 Dhjetor 2020, pra të

merrte vendim të veçantë për secilin kandidat. Sipas këtij parashikimi, kandidati është i detyruar të paraqesë formularin e vetëdeklarimit dhe se refuzimi i paraqitjes së formularit mund të përbëjë shkak për refuzimin e regjistrimit të tij si kandidat nga KSHZ. Ky vendim i komunikohet subjektit zgjedhor i cili ka të drejtën e zëvendësimit të kandidatit, që ka refuzuar dorëzimin e formularit apo nga verifikimi i të dhënave të formularit ka papajtueshmëri me të qenit kandidat apo deputet i Kuvendit. Pra ky lloji sanksioni lidhet me cilësitë e vetë kandidatit dhe nuk mund të penalizojë në tërësi subjektin zgjedhor për të marrë pjesë në zgjedhje.

### **Prapësimet e palës së paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Përfaqësuesi i KQZ-së i kërkoi Kolegjit rrëzimin e padisë, duke parashtruar të njëjtat argumente të vendosura në themel të vendimit të KAS. Ai kërkoi që pretendimet e palës paditëse të cilësohen të pabazuara në ligj dhe në prova, kurse vendimet e KSHZ e KAS të lihen në fuqi.

### **VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, referuar fakteve të mosmarrëveshjes, pretendimeve të palës paditëse dhe ligjit të zbatueshëm, vlerëson se vendimi nr. 11, datë 24.03.2021 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (sikurse edhe vendimi i KSHZ), është i ligjshëm, i bazuar në një cilësim të drejtë të fakteve, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Kolegji vlerëson kështu të pabazuara pretendimet e koalicionit “Aleanca” (AL), sepse listat e kandidatëve të këtij subjekti zgjedhor nuk përmbushin kushtet ligjore për tu pranuar në këtë proces zgjedhor.

Pretendimi kryesor i ngritur nga pala paditëse lidhet me vetë atë si subjekt zgjedhor dhe përbërjen e tij, për të cilën u parashtrua se ndryshoi nga momenti i regjistrimit në regjistrin e subjekteve zgjedhore, çka sipas palës paditëse është e ligjshme.

Lidhur me këtë çështje, para së gjithash, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor evidenton rëndësinë që paraqesin partitë politike në zhvillimin e demokracisë në përgjithësi dhe në procesin zgjedhor në veçanti. Partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit (neni 1 i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”). Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri

te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, si demokracia përfaqësuese, edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike (shih vendimet nr. 32/2010, nr. 11/2015, nr. 28/2012 të Gjykatës Kushtetuese). Për shkak të rëndësisë themelore që paraqesin, partitë politike gëzojnë edhe një status të veçante ligjor, duke u konsideruar si “pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend” (neni 3 i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”). Në këtë kuptim krijimi i partive politike, veprimtaria e tyre dhe financimi, i nënshtrohen mbikëqyrjes shtetërore për të siguruar ligjshmërinë, krahas mbështetjes dhe angazhimit shtetëror për të garantuar ekzistencën e tyre (p.sh. sigurimi i financimit nga buxheti i shtetit, përdorimi pa shpërblim i mjeteve të informimit publik, pajisja me ndërtesë për selinë qendrore dhe zyrat vendore).

Lidhur me zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë, që rregullohen nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, partitë politike evidentohen ndër subjektet më domethënëse, që krahas subjekteve të propozuar nga zgjedhësit, përbëjnë garuesit në procesin e rëndësishëm të zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe të ndershme. Regjistrimi i partisë politike si subjekt zgjedhor, konform rregullave të përcaktuara në ligj, lidhet si me ushtrimin e të drejtës për tu zgjedhur (për kandidatët e saj), ashtu edhe me marrjen e përgjegjësisë ligjore, si një detyrim që buron nga vetë ekzistenca e saj dhe qëllimi për të cilin ajo (partia) vendos të marrë pjesë në një proces zgjedhor.

Referuar sistemit zgjedhor shqiptar, nëpërmjet rregullave të Kodit Zgjedhor, parashikohet mundësia e pjesëmarrjes në zgjedhje të partive politike, qoftë si subjekteve zgjedhore të vetme, qoftë si bashkime të tyre në një subjekt të quajtur koalicion zgjedhor. Sipas nenit 2.5 të këtij Kodi, “Koalicion” është grupimi i dy apo më shumë partive politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

Në vijim, rregullat e detajuara mbi mënyrën e krijimit, regjistrimit dhe paraqitjen e kandidatëve të koalicioneve zgjedhore, përcaktohen në Pjesën IV të Kodit Zgjedhor “Regjistrimi i subjekteve zgjedhore”. Dispozitat e kësaj pjese të Kodit Zgjedhor ndërsa përcaktojnë rregulla të barabarta për subjektet zgjedhore, synojnë gjithashtu të garantojnë sigurinë e vetë procesit zgjedhor. Procesi i regjistrimit të subjekteve zgjedhore e më pas, edhe i kandidatëve i paraprin procesit të votimit, ndaj për të siguruar këtë të fundit, ligjvënësi ka caktuar afate, që referojnë pikërisht në ditën e zgjedhjeve. Kështu, jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve duhet depozituar kërkesa e partive politike për tu regjistruar si subjekte zgjedhore (neni 64.1 i Kodit Zgjedhor); jo më vonë se 60 ditë përpara datës së

zgjedhjeve duhet kryer procesi i regjistrimit të koalicioneve (neni 65.1 i Kodit Zgjedhor) dhe jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve duhet depozituar në KQZ lista e kandidatëve të subjektit zgjedhor, qoftë ky parti politike apo koalicion zgjedhor (neni 67.1 i Kodit Zgjedhor).

Krijimi i një koalicioni zgjedhor kryhet me plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet se :

*“1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.*

*2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.*

*3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”*

Në këtë proces zgjedhor, KSHZ, duke konstatuar plotësimin e kushteve të mësipërme ka vendosur të regjistrojë koalicionin zgjedhor “Aleanca” (AL), të përbërë nga shatë partitë politike, sikurse janë përmendur edhe më sipër në këtë vendim.

Më pas, procedura ka vijuar me paraqitjen e listave të kandidatëve, të cilat duhet gjithashtu të plotësojnë kushtet e Kodit Zgjedhor të parashikuara në dispozitat e neneve 67 e 68 të Kodit Zgjedhor, sikurse duhet të shoqërohen me dokumentet e kandidimit të përcaktuara në nenin 72 të këtij Kodi.

Në nenit 68 “Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve” të Kodit Zgjedhor përcaktohet se se:

*“1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. **Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë***

*bashkërisht në Kuvend një numër mandatësh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.*

...”

Dispozita e mësipërme parashikon si kusht për paraqitjen e listave të kandidatëve ose zotërimin e një mandati (për partinë politike) apo aq mandateve sa parti e përbëjnë koalicionin, ose mbështetjen e një numri të caktuar zgjedhësish. Kjo do të thotë se koalicioni “Alenaca” (AL) i përbërë nga shtatë parti politike, duhej të vërtetonte ose zotërimin prej tij të shtatë mandateve të deputetit në Kuvendin e Shqipërisë, ose mbështetjen e të paktën 7,000 zgjedhësve (nënshkrimet përkatëse). Në fakt, referuar dokumenteve tëkandidimit, koalicioni paraqiti vërtetim për zotërimin e dy mandateve në Kuvend dhe jo shtatë të tillave, çka përbën edhe shkakun kryesor për kthimin e listave për plotësim. Me rastin e ridepozitimit të listave, sërish me vërtetimin e vetëm dy mandateve në Kuvend, u parashtrua para KSHZ se pesë parti të koalicionit u tërhoqën nga marrëveshja dhe se tashme koalicioni përbëhej nga vetëm dy parti, duke kërkuar kështu që listat e kandidatëve të cilësoheshin në përputhje me dispozitën e lartpërmendur.

Referuar pikërisht fakteve që i paraprinë mosmarrëveshjes zgjedhore, Kolegji evidenton si çështjen kryesore të vënë në diskutim para organeve të KQZ-së, ligjshmërinë e “modifikimit” të koalicionit zgjedhor të regjistruar si subjekt zgjedhor. Pala paditëse pretendoi se ishte e drejtë e partive politike pjesëmarrëse në koalicion, që të tërhiqeshin nga marrëveshja e arritur më herët dhe se pas këtij qëndrimi të pesë, prej shtatë partive të koalicionit të regjistruar, ky i fundit përbëhej tashmë nga vetëm dy parti politike. Duke pretenduar se kjo sjellje e partive politike pjesëmarrëse në koalicion ishte e drejtë, edhe paraqitja e listave të kandidatëve shoqëruar kjo me vërtetimin e dy mandateve në Kuvend, sipas palës paditëse, do të duhej të ishte konsideruar si në përputhje me ligjin.

Sikurse u përmend edhe më lart, Kodi Zgjedhor ka disiplinuar në afate strikte, procesin e regjistrimit të partive politike, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit apo koalicioneve si subjekte zgjedhore. Në logjikën e ligjit, regjistrimi i një koalicioni (dy a më shumë parti politike) kushtëzohet nga regjistrimi më herët i pjesëmarrësve të tij si subjekte zgjedhore. Menjëherë pas përfundimit të këtij procesi, vijo het me depozitimin e listave të kandidatëve për çdo subjekt zgjedhor, që do të thotë se në rastin e një koalicioni zgjedhor, ai duhet të paraqesë një listë të vetme kandidatësh (partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të paraqesin lista të veçanta kandidatësh). Kjo do të thotë se, që në momentin e formësimit e më pas regjistrimit të koalicionit, vullneti i pjesëmarrësve të tij, rezulton i qartë dhe konsiston në konkurrimin e përbashkët me një listë kandidatësh. Nga ana tjetër Kodi Zgjedhor vendos si kusht për regjistrim të listës

së kandidatëve të koalicionit : ose vërtetimin e aq mandateve në Kuvend sa është numri i partive politike pjesëmarrëse në koalicion; ose paraqitja e nënshkrimeve mbështetëse nga zgjedhësit.

Në rastin në shqyrtim, pas depozitimit të listave të kandidatëve dhe konstatimit nga KSHZ se nuk vërtetohej se disponoheshin shtatë mandate në Kuvend, por vetëm dy të tilla, partia udhëheqëse e koalicionit pretendoi se pesë nga partitë e koalicionit ishin tërhequr sipas deklaratës së datës 12.03.2021 dhe së tashmë koalicioni ALEANCA (AL) përbëhej nga vetëm dy parti. Mbi këtë bazë, në mbledhjen e KQZ, në të cilën do të shqyrtohej ndreqja e mangësive të listave të kandidatëve, u kërkua që ato të regjistroheshin, pasi plotësohej kushti mbi mandatet që duhet të disponojë koalicioni. Si KSHZ ashtu edhe KAS vlerësuan se koalicioni Aleanca ishte ai, i cili ishte regjistruar në KQZ dhe se një ndryshim i tij nuk ishte i mundur pas regjistrimit.

Është pikërisht kjo çështja e cila i jep përgjigje edhe pretendimit të ngritur në padi dhe që u mor në shqyrtim nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor. A mundën partitë politike pjesëmarrëse në një koalicion zgjedhor, të tërhiqen nga kandidimi pasi koalicioni është regjistruar si subjekt zgjedhor?

Kolegji vlerëson se pas regjistrimit të një subjekti zgjedhor, është e pamundur që ai të çregjistrohet si i tillë, ashtu sikurse pas regjistrimit të një koalicioni zgjedhor si subjekt zgjedhor, një, disa, apo të gjithë partitë politike, që e përbëjnë atë të tërhiqen nga kandidimi apo nga koalicioni. Në parim, çdo individ dhe çdo parti politike janë të lirë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në zgjedhjet që zhvillohen. Nga ana tjetër, nëse kandidati apo partia politike regjistrohen si subjekte zgjedhore, konform rregullave të Kodit Zgjedhor, është e pamundur tërheqja e tyre nga gara në çfarëdo forme qoftë ajo. Në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor nuk parashikohet mundësia e subjekteve zgjedhore që të tërhiqen nga procesi zgjedhor. Caktimi i afateve lidhur me procesin e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, në raport me datën e zgjedhjeve dhe garantimi i stabilitetit, ndalojnë çdo sjellje që synon të ndryshojë situatën faktike dhe ligjore mbi atë, çka KQZ tashmë ka vendosur për subjektet që i nënshtrohen garës. Sikurse u trajtua më sipër në këtë vendim, partia politike ka jo vetëm të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje, por njëkohësisht ajo është edhe subjekt i së drejtës zgjedhore që mbart përgjegjësi kundrejt këtij procesi. Për rrjedhojë, angazhimi në një proces zgjedhor, sipas vullnetit të formalizuar para KQZ-së, e ngarkon partinë politike sikurse edhe bashkimin e tyre si koalicion, me përgjegjësinë për të vijuar garën, me të njëjtat cilësi të pasqyruara në regjistrin e subjekteve zgjedhore. Marrëveshja për koalicionin zgjedhor, që nënshkruhet nga partitë pjesëmarrëse, i nënshtrohet rregullave të së drejtës publike dhe në këtë kuptim, palët nënshkruese të marrëveshjes nuk mund ta zgjidhin atë qoftë në mënyrë të njëanshme, qoftë



me një marrëveshje të re mes tyre. Interesi publik për stabilitet të procesit zgjedhor, prevalon mbi vullnetin e një apo disa partive për tu tërhequr nga gara, nëse kjo tërheqje do të synonte të ndryshonte vendimet e mëparshme të KQZ-së. Në këtë kuptim, një tërheqje nga gara e manifestuar me mosveprimin në procesin e paraqitjes së listave të kandidimit, nuk pas sjell asnjë anomali të procesit, pasi paraqitja e listave të kandidatëve është fakultative. Nga ana tjetër, një modifikim i subjektit zgjedhor të regjistruar më parë, është praktikisht i pamundur për sa kohë që sjellje të tilla do të vinin në rrezik vetë procesin. Pretendimi i palës paditëse se KAS dhe KSHZ nuk e mbështetën vendimin e tyre në asnjë dispozitë ligjore, që ndalon tërheqjen e partive nga koalicioni, është i pabazuar. Kodi Zgjedhor nuk ka asnjë dispozitë që të lejojë sjellje të tilla të subjekteve zgjedhore, përfshirë këtu edhe dorëheqjet individuale të kandidatëve. Kjo do të thotë se me regjistrimin si të subjekteve zgjedhore, ashtue dhe të kandidatëve, asnjë ndryshim nuk është i lejuar.

Pamundësia e tërheqjes nga gara e subjektit zgjedhor është trajtuar edhe më herët nga Kolegji Zgjedhor, në vendimin nr. 18, datë 05.06.2015. Në atë rast, çështja që u paraqit në Kolegj, lidhej me dorëheqjen e një subjekti zgjedhor, kandidat për kryetar bashkie, shoqëruar me kërkesën e partisë politike përkatëse për ta zëvendësuar atë kandidat me një tjetër. Kolegji Zgjedhor, duke bërë një interpretim logjik dhe historik të dispozitave të Kodit Zgjedhor, vlerësoi se, pas regjistrimit të kandidatit, ai nuk mund të paraqesë dorëheqjen nga kandidimi. Kolegji Zgjedhor ka konsideruar se ndryshe nga kuptimi i përgjithshëm që ka dorëheqja, në rastin e procesit zgjedhor prevalon interesi publik i stabilitetit të zgjedhjeve, karshi atij individual.

Nisur nga argumentet e mësipërme, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se pas regjistrimit të koalicionit zgjedhor, as ai vetë dhe as partitë politike pjesëmarrëse në të, nuk mund të tërhiqen nga kandidimi dhe përbërja e koalicionit do të mbetet ajo, që është pranuar në vendimin për regjistrimin e tij, konform marrëveshjes mes partive pjesëmarrëse dhe kushtet e marrëveshjes. Ashtu sikurse arsyeton KAS, tërheqja nga gara e pesë partive të koalicionit, sjell praktikisht në garë një koalicion të ri, të ndryshëm nga ai i regjistruar, konformrregullave të Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se partitë pjesëmarrëse në koalicion janë elementi më i rëndësishëm i këtij subjekti zgjedhor dhe relativizimi i palës paditëse duke i'u referuar vetëm numrit të domosdoshëm për krijimin e një koalicioni, nuk vjen në përputhje me ligjin. Nëse do të pranohej në parim e drejta e partive pjesëmarrëse në një koalicion për tu tërhequr nga kandidimi, sikurse ka ndodhur në këtë rast, procesi zgjedhor do të rrezikohej pasi do të duhej të pranohej se tërheqja mund të bëhet nga të gjitha partitë e koalicionit. Në një rast të tillë, pasoja do të ishte mos ekzistenca e koalicionit tashmë të regjistruar, që nuk mund të pranohet nga logjika e

Kodit Zgjedhor. Partitë politike duhet të jenë aq të përgjegjshme sa të konsolidojnë brenda afateve të caktuara në Kodin Zgjedhor nëse do të marrin pjesë në zgjedhje, duke vendosur kështu të regjistrohen apo jo si subjekte zgjedhorë, dhe më pas, nëse do të garojnë të vetme apo do të bashkohen në një koalicion zgjedhor me parti të tjera politike, duke realizuar regjistrimin e koalicionit. Çdo zgjedhje e partive politike në këtë proces shoqërohet me vendime të KQZ, që janë të pakthyeshme. Mbi bazën e vlerësimit të mësipërm, Kolegji gjen të pabazuar pretendimin e koalicionit “Aleanca” (AL), lidhur me përbërjen nga dy parti politike. Në të kundërt, ky koalicion përbëhet nga shtatë parti politike, sikurse është vendosur me vendimin e KSHZ për regjistrimin e tij si subjekt zgjedhor. Deklarata e pesë partive të koalicionit e datës 12.03.2021 (një ditë pas vendimit të KSHZ për kthimin e listave të kandidatëve për plotësim), nuk sjell asnjë pasojë ligjore mbi subjektin tashmë të regjistruar. Kjo sjellje e partive, ndërsa nuk lejohet nga ligji, ngjan si një përpjekje për ta modifikuar koalicionin në varësi të numrit të mandateve të deputetëve që ai zotëronte (dy të tilla), çka u la të kuptohet edhe gjatë parashtrimeve para Kolegjit.

Si përfundim, në rrethanat kur koalicioni “Aleanca” (AL), nuk e plotësoi kushtin për zotërimin e shtatë mandateve të deputetit dhe as nuk paraqiti nënshkrime mbështetëse nga zgjedhësit, vendimi i KAS që la në fuqi vendimin e KSHZ, për refuzimin e listave të kandidatëve të këtij subjekti zgjedhor, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit.

Lidhur me mangësitë e tjera të evidentuara në vendimin për refuzimin e listave të kandidatëve, Kolegji ndërsa i vlerëson edhe këto pretendime të palës paditëse të pabazuara, i gjen gjithashtu jo relevante, për sa kohë që kushti kryesor për paraqitjen e listave nuk rezulton i përmbushur. Gjithsesi, Kolegji evidenton se lidhur me mangësitë e tjera, vetë pala paditëse pranoi ekzistencën e disa prej tyre, duke kërkuar që ato të cilësohen si gabime materiale. Ky pretendim i palës paditëse vlerësohet i pabazuar, për faktin se listat e kandidatëve ishin kthyer pikërisht për tu plotësuar mbi mangësitë e konstatuara. Po ashtu edhe ky proces (regjistrimi i kandidatëve), kryhet në afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, ndaj subjektet zgjedhore duhet të tregojnë kujdesin maksimal, që listat të jenë në përputhje me ligjin. Pala paditëse pretendoi se nuk ishte ndihmuar nga administrata e KQZ-së, ndërsa nuk rezulton asnjë fakt që nga ky subjekt zgjedhor të jetë kërkuar asistencë apo informacion shtesë mbi aspekte të veçanta mbi listat e kandidimit. Ky pretendim nuk qëndron edhe sepse vetë pala paditëse i konsideroi mangësitë si gabime materiale apo njerëzore, çka tregon se ka qenë faji (pakujdesia) i vetë subjektit zgjedhor, që solli mangësitë në listat e kandidatëve. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendoi pala paditëse, mangësitë e

konstatuara nuk mund të ndreqeshin nga KQZ, pasi ato nuk ishin thjesht gabime materiale por edhe përmbajtësore (si psh rasti i kandidimit të të njëjtit kandidat në disa zona zgjedhore).

Si konkluzion, pretendimet e subjektit zgjedhor “Aleanca” (AL) kundër vendimit të organeve të KQZ-së për refuzimin e listave të kandidatëve, vlerësohen të pabazuara në ligj, ndaj edhe kërkimi për ndryshimin e këtyre vendimeve nuk pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158, pika 3 të Kodit Zgjedhor

## **V E N D O S I**

- Rrëzimin e padisë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi.

U shpall në Tiranë, në datë 31.03.2021.

**GJYQTARE**

**GJYQTARE**

**GJYQTARE**

**Emona MUÇI**

**Alma KOLGJOKA**

**Edlira PETRI**

**GJYQTARE**

**GJYQTAR**

**Esmeralda ÇEKA (XHILI)**

**Gentian MEDJA**